



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 670 prot.

Durrës, më 20/02 / 2025

VENDIM

Nr. 13, datë 20.02.2025

PËR
"MIRATIMIN E PARAFINANCIMIT TË PROJEKTIT INTERREG, ADRION PROGRAMME
"SAMESEA" PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 49, gërma c, të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8 datë 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj", Ligjin, nr.43/2016 Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 533, datë 04.10.2017 "Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Europian, për programin Interreg V-B Adriatiko— Jonian (ADRION) 2014-2020", Rregullores Financiare të UAMD, Rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit, shkresën 610 prot., date 17.02.2025 të drejtueses së projektit, , Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Miratimin e parafinancimit të shpenzimeve të projektit INTERREG/"SAMESEA" për vitin 2025, si vijon:
 - ✓ Vlera e financimit të projektit do të jetë 1 540 000 lekë, sipas zërave të përcaktuara në buxhetin e projektit.
2. Burimi i financimit do të jetë nga buxheti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
3. Shpenzimet e kryera në kuadër të financimit të projektit të sipërcituar do të rimbursohen nga fondet e përfituara nga donatori në kuadër të projektit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

